



Asociacioni i Komunave të Kosovës

Raport nga Takimi i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

Për: Shefat/Zyrtarët Ligjor të Komunave
Nga: Shqipe Arifaj – Zyrtare Ligjor e AKK-së
Kopje: z.Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së
Data : 27 prill 2011
Subjekti : Raporti i takimit të dytë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor



27 prill 2011, Restoranti "Ambient" Prizren

HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e dytë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2011.

Sipas planit të punës për vitin 2011, një prej objektivave është caktuar harmonizimi i akteve ligjore, dhe takimi i dytë kishte për qëllim diskutimin e Ligjit të Shërbimit Civil në Kosovë.

Në këtë takim morën pjesë zyrtarët ligjor të komunave dhe zyrtarja ligjore e AKK-se znj. Shqipe Arifaj .

PËRMBLEDHJE

Takimin e hapi dhe kryesoi zv.kryesuesi i KZL-së **z.Hevzi Matoshi**, i cili i përshëndeti të pranishmit, prezantoi referuesin për diskutimin për Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës z.Besim Azizi dhe fjalën ia dha përfaqësuesit të AKK-së .

znj.Shqipe Arifaj – e cila përshëndeti zyrtarët ligjor pjesëmarrës në këtë takim, po ashtu i njoftoi zyrtarët se Kryesia e KZL-së kanë mbajtur takim në zyrat e AKK-së për planin e punës për vitin 2011, sipas objektivave të përcaktuara në plan të punës do të punohet gjatë këtij viti , si dhe i njoftoi se AKK-ja ka mbajtur takim me kryetarët e Komunave për shumë çështje me të cilat po ballafaqohen komunitat, dhe për Strategjinë Legjislative , për të cilët kryetarët e komunave kishin kërkuar pjesëmarrje në 56 projektligje, ndër ta janë 3 projektligje që është menduar që grupet punuese mund të pjesëmarrin zyrtarët Ligjor

z.Matoshi- prezantoi rendin e ditës :

1. Shqyrtimi i raportit nga mbledhja e kaluar;
2. Miratimi i propozim-rregullores së punës së KZL-së;
3. Diskutimi për Ligjin për Shërbimin Civil - referues z.Besim Azizi-Menaxher i Personelit- Komuna Gjilan
6. Të ndryshme.

Pika e parë: Shqyrtimi i raportit nga mbledhja e kaluar

U miratua, pa asnjë vërejtje.

Pika e dytë: Miratimi i propozim-rregullores së punës së KZL-së

z.A.Salihu – Së pari kërkoj falje për vonesën time, për arsye të komunikacionit të dendur. Në takimin e parë që e kishim në Ferizaj, ne e shqyrtuam draft-rregulloren e cila është unike për të gjitha kolegjiutet, mirëpo nuk vendosëm për mandatit kryesisë a duhet të jetë dy vite apo katër vite dhe në nenin 10 duhet të ndryshohet fjala propozime me Rekomandime.

U pajtuan të gjithë që mandati i anëtarëve të kryesisë së KZL-së të jetë katër vjeçar si dhe në nenin 12 të Rregullores në vend të fjalës Vendime të jetë Rekomandime.

Me këto plotësime miratohet Rregullorja e Punës së Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor .

Pika e tretë : Diskutimi për Ligjin për Shërbimin Civil

z.Besim Azizi- Udhëheqës i Personelit në Komunën e Gjilanit - Ju pershendes te gjithëve, sot do te flasim se bashku për Ligjin për Shërbimin Civil, i cili botuar në Gazetën Zyrtare më 25 qershor 2010 dhe ka hy në fuqi më 10 korrik 2010. Shume dispozita të këtij ligji nuk kanë mundur të aplikohen për arsye të të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Ligji për Shërbimin Civil ka 10 kapituj, me këtë ligj rregullohet statusi i shërbyesve civil dhe lokal. Procedurat e punësimit janë shumë të koklavitura, shkon deri në një muaj e gjysmë deri sa të pranohet në marrëdhënie pune një nëpunës civil. Intervista është edhe me shkrim edhe me gojë. Me Udhëzimin Administrativ 2/10 janë nëpunësit civil janë ndarë në nëpunës civil të karrierës- natyra e punës është e pa-afatshme dhe jo të karrierës- natyra e punës është me kohë të caktuar , më së shumti dy (2) vite. Janë përcaktuar katër(4) kategori të nëpunësve civil dhe katërmbëdhjetë (14) grada të nëpunësve civil, mirëpo ende nuk është nxjerr akti nënligjor me përcaktuar pozitë ne nëpunësit civil se në cilën kategori bie. Pastaj Rregullorja për komisionin disiplinor dhe atë të ankesave ende nuk është nxjerr. Orari i punës është përcaktuar 8 orë në ditë, mirëpo puna me orar të shkurtuar ende nuk është rregulluar me dispozita ligjore. E kemi edhe një zbrazëti tjetër- pushimet e veçanta. Shndërrimi i kontratave në akt emërimi, kjo është e pa-afatshme mirëpo duhet që dy (2) vitet e fundit nëpunësi civil të jetë vlerësuar pozitiv. Gradimet nuk lejohen pa konkurs interno

z.Agim Salihu – Arsyeja pse e kemi paraparë të diskutojmë këtë ligj edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejtë me zyrën ligjore ka qenë çështja e sistematizimit të vendeve të punës, besojmë se së bashku me AKK-në të punojmë që të kemi një dokument të përgjithshëm për të gjitha komunat, ndoshta disa komuna kanë punuar diqka individualisht në këtë drejtim, mirëpo me ligjin e ri disa gjëra kanë ndryshuar.

z.Hevzi Matoshi – Ky ligj që është duhet të zbatohet, më mirë një ligj i keq, se sa mos me pas ligj fare, sepse do të krijohej anarki.

- Pyetjet- pse nuk lejohet buxhet për zyrën e personeli?
- Pse me kërkuar leje prej ministrisë së Administratës Publike për pozitat ekzistuese, për ato të reja është e kuptueshme?
- Pse po iu ruhet vendi i punës kandidatëve që po bëhen drejtor të shkollave?

z.Besim Azizi- Buxheti varet prej komunës, se si vendos, ndërsa pse ka mbetur me kërkuar leje nga MAP-ja, për arsye se ata menaxhojnë me lista të pagave për shkak të evidencave të sakta. Po ashtu edhe ruajtja e vendeve të punës për drejtorët e shkollave, këtë mund ta bëjnë secila komunë veç e veç me vendim të veçantë, kështu ka vepruar Gjilani, edhe pse nuk është e rregulluar me ligj kështu.

Pika e katërtë: Të ndryshme

- a) Shqyrtimi i kërkesës së Kolegjiut për Urbanizëm " A është Drejtoria për Urbanizëm kompetente për lejimin e reklamave dhe cilat janë procedurat të cilat duhet të zhvillohen për shqyrtimin e këtyre kërkesave" ?

z.Matoshi- Kryesia e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor i është përgjigjur kësaj kërkesë, por deshëm të ju njoftojmë juve si anëtar të Kolegjiut. Nga kjo nënkuptohen se rëndësia e KZL-ës është e madhe dhe bashkëpunimi mes kolegjiutëve është në nivel të kënaqshëm.

Përgjegjja të cilën ia kemi dhënë Kryesisë së Kolegjiut për Urbanizëm :

Dhënja e pëlqimit-kushteve të lokacionit, përkatësisht lejes së ndërtimit-vendosjes, është ekskluzivisht në kompetencë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në disa komuna me formimin e drejtorive për Shërbime Publike këto kompetenca kanë kaluar në to.

REKOMANDIME :

- ❖ **U miratua rregullorja e punës së KZL-së e cila do të jetë akti që rregullon mbarëvajtjen e punës së KZL-së ;**
- ❖ **Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës ende nuk mund të zbatohet në tërësi për arsye të mos nxjerrjes së rregulloreve për zbatim të ligjit;**
- ❖ **Roli dhe rëndësia e KZL-së është në ngritje e sipër ;**